UDHËZIM
Nr. 19, datë 5.8.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 4059/2, DATË 7.6.2016 "PËR ANONIMIZIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE NË VENDIMET GJYQËSORE QË PUBLIKOHEN NË PORTALIN ELEKTRONIK TË GJYKATAVE"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Pika 2, e nenit 6, të udhëzimit nr. 4059/2, datë 7.6.2016 "Për anonimizimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore që publikohen në portalin elektronik të gjykatave" të ndryshohet, si më poshtë vijon;

Emërtimi "Këshilli i Lartë i Drejtësisë" zëvendësohet me "Këshilli i Lartë Gjyqësor".

2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)